

TERMA REFERENCË

1. Informacion i përgjithshëm:

Kontraktues	–	Q- Lever shpk
Emri i projektit	–	IN ESG
Kontakt	–	Jetnor Sokoli
		info@qllever.al

IN ESG është pjesë e shërbimeve që ofron kompania Q-Lever një anëtare e rrjetit Global Reporting Initiative.

Nëpërmjet shërbimeve IN ESG ne synojmë që të rrisin ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve lidhur me implementimin e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm. Synimi jonë është t'i ofrojmë komunitetit të biznesit teknikat dhe mjetet për implementimin dhe raportimin e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm të cilat shkojnë në harmoni me manaxhimin efektiv financiar të biznesit. Po ashtu ne synojmë që të ndërveprojmë me akademinë për nxitjen e kërkimit shkencor dhe shkollat e formimit profesional për edukimin dhe nxitjen e praktikave Green.

Një komponent i rëndësishëm është edhe komunikimi me institucionet publike lidhur me përfshirjen e praktikave të qëndrueshme në politikëbërje.

Ne jemi të privilegjuar që Agjensia e Start UP ka zgjedhur projektin tonë fitues dhe do na mbështesë në zhvillimin e platformës për trajnimet online dhe organizimin e konferencës për përfitimet që ka ekosistemi nga implementimi i praktikave të qëndrueshme.

Për realizimin e objektivave të sa më sipër shoqëria Q-Lever kërkon të krijojë një listë me ekspertë të specializuar në fushat e mëposhtme.

1. Ekspertë të specializuar në shërbimet financiare
2. Ekspertë të specializuar në shërbimet Ligjore
3. Ekspertë të specializuar në shërbimet e IT
4. Ekspertë të specializuar në përmirësimin e mjedisit
5. Ofrues trajnimesh
6. Ekspertë në implementimin e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm
7. Ekspertë në raportimin e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm
8. Ekspertë që merrem me kërkimin shkencor
9. Ekspertë të specializuar në politikëbërje

Të interesuarit të regjistrohen në <https://qllever.al/formexpert.html> ose të dërgojnë një kopje të jetëshkrimit të tyre profesional në info@qllever.al

2. Në momentin e prekualifikimit si ekspert, dokumentat që nevojitet të paraqiten janë:

- Kopje të diplomes universitare në fushën e financave, shkenca mjedisore ose shkenca sociale
- Jetëshkrim të përditësuar ku specifikohet eksperiencia relevante me projektin
- Kopje të mjetit të identifikimit
- Certifikata që konfirmojnë ekspertizen në fushën e raportimit të zhvillimit të qëndrueshëm
- Dëshmi penaliteti
- Ofertë financiare